

Raporti vjetor 2021

Aktiviteti i QKEV për vitin 2021 sipas sektorëve të institucionit është i përshkruar si më poshtë:

1. Certifikimi i profesionistëve të shëndetësisë

Sektori i certifikimit është përgjegjës për regjistrimin profesionistëve në programin e certifikimit si dhe për regjistrimin e krediteve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë bazuar kjo në procedurat, kriteret dhe standartet e parashikuara të Programit të Certifikimit. QKEV-ja ka krijuar një regjistër elektronik, i cili ruan të dhënat për të gjithë profesionistët e regjistruar. Profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit janë: mjekët, stomatologët, farmacistët e ndihmësfarmacistët dhe infermierët e mamitë, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ofrojnë shërbime shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe terciar dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore. Profesionistët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të edukimit në vazhdim, të zgjedhura nga ata vetë, nisur nga nevojat e tyre personale dhe institucionale dhe në përmbushje të kriterëve të kërkuara në programin e Certifikimit; si dhe në varësi të aktivitetëve të ofruara gjatë një viti ose gjatë një cikli brenda ose/dhe jashtë vendit.

Programi i Certifikimit është i organizuar në cikle individuale brenda të cilit profesionistët e shëndetësisë duhet të përmbushin kriteret:

- numri i krediteve të kërkuara mjekët duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 150 kredite të edukimit në vazhdim, stomatologët dhe farmacistët e ndihmësfarmacistët 75 kredite, ndërsa infermierët e mamitë 50 kredite.
- deri në 50% e krediteve duhet të jenë nga specialiteti
- çdo vit duhet të marrin minimalisht mjekët 10 kredite, farmacistët dhe stomatologët 5 kredite

jo më shumë se 20% e krediteve nga aktivitete të vetëraportuara (lexim libri)

Detyrat kryesore të sektorit të certifikimit janë:

- 1.Rregjistrimi në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë
- 2.Rregjistrimi i krediteve të aktivitetëve të edukimit në vazhdim të akredituara prapakisht nga QKEV
- 3.Rregjistrimi i krediteve të aktivitetëve të edukimit në vazhdim të ofruara nga ofrues të akredituar dhe nga ofrues të tjerë si QKEV
- 4.Rregjistrimi i krediteve nga aktivitete të vetëraportuara.
- 5.Hartim i raporteve sipas kërkesave të titullarit të QKEV apo të institucioneve shëndetësore

Në zbatim të detyrave gjatë vitit 2021 në rregjistrin e profesionistëve janë rregjistruar për herë të parë 1125 profesionistë nga të cilët:

mjekë 190

stomatologë 198

farmacistë ndihmës farmacistë 183

infermierë 554

Gjatë vitit 2021 janë certifikuar rreth 1158 profesionistë.

Bazuar në të dhënat e regjistruara deri më sot gjatë vitit 2021 kanë marrë pjesë në aktivitetet të Edukimit në Vazhdim:

mjekë 3242

stomatologë 1557

farmacist nd/farmacist 1941

infermier 6416

Për vitin 2021 kanë kryer detyrimin minimal sipas kategorisë së profesionit:

mjekët që kanë marrë minimalisht 10 kredite 2484

stomatolog që kanë marrë minimumin 5 kredite 1543

farmacist nd/farmacist që kanë marrë minimumin 5 kredite 1760

Janë bërë modifikime dhe janë regjistruar ciklet individuale në 2388 kartela profesionistësh.


Janë regjistruar kreditet e marra nga aktivitete të vetëraportuara dhe sipas kërkesave për njohje kreditesh për 3060 profesionistë sipas kategorive që i përkasin (artikuj, botime, lexim librash, pjesëmarrje në aktivitete të huaja, specializime doktoratura etj).

2. Akreditimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim

Viti 2021 në vecantinë e tij përshkak të pandemisë nga Covid 19, ka qënë një vit jo i zakonshëm dhe për sa i takon zhvillimit dhe akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Kufizimet e vendosura për organizimin e aktiviteteve live nga MSHMS në funksion të masave të luftës kundër pandemisë, ndikuan në formatet e ofrimit të këtyre aktiviteteve nga ofruesit e shumtë të tyre. Në krahasim me vitin paraardhës është vënë re një rritje e ndjeshme e aplikimeve dhe kërkesave për përsëritje të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Gjatë vitit 2021, si aplikime fillestare u procesuan rreth 250 aplikime për aktivitete të edukimi në vazhdim. Gjithashtu janë verifikuar dhe ndjekur për kryerjen konform kriterëve dhe standardeve të njohura rreth 370 kërkesa për përsëritje aktiviteteve (të akredituara më parë Brenda një periudhe kohore prej 3 vitesh. Pra në total janë procesuar apo janë në proces akreditimi rreth 620 aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë

Këto shifra në krahasim me vitin e shkuar janë afërsisht më të larta, gjë që tregon tendencën e mirë në rritje të numrit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë gjatë vitit 2021, sic paraqitet dhe në grafik 1.



Grafiku nr. 1

2.1 Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas llojit të tyre

Aktivitetet e llojit trajnim kanë mbizotëruar në shumatoren e aktiviteteve për vitin 2021. Kjo ka qënë një tendencë dhe në vitet e shkuara për këtë format aktiviteti, por që këtë vit është maksimalizuar dhe nga detyrimi, që ju kushtëzua ofruesve në funksion të respektimit masave parandaluese për mbrojtjen ndaj Covid 19, me organizimin e aktiviteteve me një numër të kufizuar pjesëmarrësish, në ato periudha kohore kur kjo gjë ishte e mundur dhe e lejuar.


Duhet theksuar, që shumë nga këto aktivitete kanë qënë aktivitete të akredituar të ofruara nga QSH, që kanë ofruar aktivitete trajnimi të formatit Grupe Kolegësh nën mbështetjen e programit HAP të financuar nga Kooperacioni Zviceran në Tiranë, por dhe aktivitete të ofruara nga shoqata mjekësore që kanë pasur një veprimtari mjaft aktive në Tiranë, por dhe ne qarqe të ndryshme të vendit.

Aktivitetet e formatit online jo sinkron, kryesisht i takojnë aktiviteteve të përsëritura nga disa ofrues që tashmë janë aktivë në ofrimin e këtyre aktiviteteve.

Ndërkohë është rritur ndjeshëm numri i aktiviteteve on line të tipit sinkron (me mbi 150 aktivitete) të ofruar nga një numër i madh ofruesish. Nevojat e kushtëzuara nga pandemia e kanë bërë këtë format aktiviteti të preferuar dhe mjaft të shpeshtë në kërkesat e ofruesve për to.

2.2 Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas target grupit

Ka një numër më të lartë të aktiviteteve, që fokusojnë kategorinë e infermiereve dhe mamive, si dhe aktiviteteve me target të përbashkët për mjekët e familjes dhe infermiret e KSHP. Kryesisht aktivitetet me target mjekë familje + infermirë janë ofruar nga QSH dhe njësitë e operatorëve publikë të ofrimit të kujdesit shëndetësor, ndërsa aktivitete vetëm për infermiret janë ofruar nga shoqatat e infermiereve dhe UISH. Gjatë këtij viti është bërë një fokusim i madh i punës së QKEV në selektimin sa më të saktë të kategorive profesionistëve që targetojnë aktivitetet e edukimit në vazhdim me qëllim një lidhje sa më reale midis trajnimve të ofruara dhe vlefshmërisë së tyre për kategoritë përkatëse.



2.3 Aktivitetet e edukimit në vazhdim sipas burimit financiar

Kanë mbi zotëruar aktivitetet e financuara nga vete ofruesit e aktiviteve. Me tej vazhdojnë aktivitetet e financuara nga kuotat e pjesëmarrjes. Këto aktivitete janë kryesisht aktivitete të ofruara nga shoqatat mjekësore dhe OJF. Aktivitetet, që janë financiar nga vetë organizata që ka ofruara aktivitetin, janë QSH, që kanë pasuar mbështetje e HAP, ose ato aktivitete të ofruara nga operatorë të kujdesit shëndetësor parësor publik, që kanë mbështetur financiarisht vetë organizimin e këtyre aktiviteve, por dhe shumë ofrues të tjerë si shoqata mjekësore apo OJF dhe ofrues të dedikuar për edukim në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë.



2.4 Aktivitete sipas kategorive të ofruesve të aktiviteve të edukimit në vazhdim

Vendin kryesor në ofrimin e aktiviteve kryesisht me pagesë për pjesëmarrësit e mbajnë shoqatat mjekësore dhe OJF të ndjekura nga ofrues QSH të sistemit publik që ofrojnë aktivitete të formatit trajnim apo dhe grupe kolegësh ato QSH që kanë mbështetjen e programit HAP. Numri i aktiviteve të ofruara nga kategoria e Urdherave të profesionistëve i takon kryesisht UISH dhe UMSH. Ky I fundit ka qënë mjaft aktiv sidomos me degët e tij në qarqe.

3 Monitorimi dhe cilësia e aktiviteve të edukimit në vazhdim

Detyra kryesore e sektorit të monitorimit është garantimi i zbatimit të standardeve të cilësisë së edukimit në vazhdim përmes procesit të monitorimit të aktiviteve të akredituara nga QKEV ose nga Ofruesit e Akredituar. Në total gjatë vitit 2021 janë monitoruar gjithsej 31 aktivitete të edukimit në vazhdim dhe monitorimi vjetor i planifikuar i të gjithë ofruesve të akredituar.

Nga këto aktivitete monitorimet janë bërë kryesisht në Tiranë dhe online nga stafi i QKEV.

Edhe gjatë këtij viti si gjatë vitit 2020-të i është kushtuar rëndësi e veçantë monitorimit të aktiviteteve online. Edhe pse gjatë këtij viti është shtuar numri i aktiviteteve në sallë sipas protokolleve të pandemisë të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shumë ofrues kanë vazhduar të zhvillojnë aktivitete online.

Problematikat e vërejtura gjatë monitorimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim gjatë vitit 2020 janë disa:

1. Zbatimi i programit sipas kohëzgjatjes së tij dhe me të gjitha rubrikat e interaktivitetit të planifikuara nga ofruesi gjatë procesit të akreditimit.
2. Zbatimi i standardeve të konfliktit të interesit
3. Interaktiviteti dhe ngazhimi i pakët i pjesëmarrësve në shkëmbimin dhe diskutimin e mendimeve dhe eksperiencave.
4. Vlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve gjatë aktiviteteve online sinkron si detyrim për marrjen e krediteve.
5. Zbatimi i standardeve të distancës fizike të pandemisë për aktivitet në sallë.

Gjatë këtij viti në zbatim të VKM Nr.440, datë 17.05.2017 “Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve dhe procedurave të procesit të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë” është kryer dhe monitorimi i planifikuar i të gjithë ofruesve të akredituar:

1. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, Nëntor 2021
2. Sëiss Foundation for Innovation, monitorim i kryer në Nëntor 2021
3. Fondacioni ABC, monitorim i kryer në Nëntor të 2021-shit.
4. Albanian University, në Nëntor 2021
5. Universiteti i Mjekësisë Tiranë, në Dhjetor 2021.

Monitorimet u realizuan nga grupet e punës të ngritura nga Drejtori i institucionit për secilin ofrues të akredituar.

Grupi i punës pas verifikimit të dokumentacionit të procedurave të akreditimit për aktivitetet e akredituara nga vetë ofruesit dhe verifikimit të kriterëve të tjera sipas legjislacionit në fuqi përpiluan raportin final të monitorimit.

Këto raporte bashkë me gjetjet e rekomandimet do të paraqiten për diskutim e miratim tek Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm.

Gjatë vitit 2021 sektori i monitorimit mori pjesë dhe në aktivitete edukuese të stafit të Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe takime me ofruesit e aktiviteteve.

1. Në Shtator të 2021 u organizuan dy takime me disa pjesëtarë të stafit të QKEV me qëllim rritjen e kapaciteteve monitoruese për të ndihmuar sektorin i cili ka mungesa.
2. Në fillim Nëntor të 2021 u krye një takim me pjesëmarrje të gjerë të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim ku dhe sektori i monitorimit bëri një prezantim dhe mori pjesë në pyetjet dhe diskutimet e shumta.

3. Në Dhjetor të 2021 u krye një trajnim stafi me qëllim përditësimin e njohurive ndërsektoriale ku dhe sektori i monitorimit bëri një prezantim dhe kontribuoi në qëllimin e takimit.

Disa objektiva të Sektorit të Monitorimit dhe Cilësisë për vitin 2022 për aktivitet në distancë sinkron dhe josinkron janë:

- Hartimi i një plani takimesh (*ose ngritja e nje grupi pune/forumi*) me kordinatorët e ofruesve të akredituar dhe anëtarë të organizatave të tjera të përfshira në proces për informim dhe shkëmbim eksperiencash lidhur me veprimtarinë e tyre të deritanishme dhe implementimin e rekomandimeve të lëna nga monitorimi në periudhën në vazhdim.
- Organizimi i aktiviteteve rifreskuese mbi zbatueshmërinë e standardeve të cilësisë së monitorimit të aktiviteteve të EV. Gjetja e mekanizmave për nxitjen e aktiviteteve në sallë dhe online me numër të vogël pjesëmarrësish që kanë në fokus të mesuarit në mënyrë praktike dhe interaktivitetin, jo thjesht përmes leksioneve.
- Rritja e kapaciteteve digjitale monitoruese cilësore të stafit të QKEV dhe Ofruesve të akredituar për aktivitetet e EV, sidomos për ato të edukimit në distancë (*online*).
- Qartësimi i rolit të kordinatorit të edukimit në vazhdim lokal në rrethe nga MSHMS.

4. Komunikimi dhe marrdhëniet me publikun


QKEV gjatë vitit 2021 ka ndarë rregullisht informacion me profesionistët në lidhje me kriteret dhe detyrimet e programit të certifikimit dhe gjendjen aktuale të krediteve. Gjithashtu sipas kërkesave janë pajisur me kodet personale për aksesin në sistem, si dhe me vërtetim kreditesh në raste rilicensimi.

Gjatë vitit 2021 janë pritur dhe shërbyer pranë zyrave tona rreth **3832** profesionistë. Ka patur komunikim përmes telefonit fiks dhe celularit me afërsisht **6800** profesionistë.

Nëpërmjet postës elektronike u jemi përgjigjur rreth **6286** profesionistëve. Përmes rrjeteve sociale kemi komunikuar me mbi **634** profesionistë. Kemi pajisur me vërtetim kreditesh rreth **937** profesionistë të shëndetësisë

Në kalendarin e aktiviteteve, të publikuar në portalin elektronik të QKEV, janë pasqyruar me saktësi dhe në kohë të gjitha aktivitetet e akredituara nga QKEV ose nga Ofruesit e Akredituar. Janë pasqyruar **656** aktivitete në Kalendarin e Aktiviteteve të Akredituara nga QKEV dhe **73** aktivitete në Kalendarin e Aktiviteteve të Ofruesve të Akredituar nga QKEV.

Shërbimet e ofruara gjatë 2021



- Shërbim profesionistëve të paraqitur fizikisht në QKEV 3832
- Shërbim profesionistëve përmes telefonit 3625
- Shërbim profesionistëve përmes rrjeteve sociale 634
- Vërtetim Kreditesh 937
- Përditësimi i Kalendarit me aktivitete të akredituara në faqen zyrtare 729
- Shërbim profesionistëve përmes postës elektronike 6286
- Shërbim profesionistëve përmes numrit të celularit të vënë në dispozicion të profesionistëve 3132

5. Financa dhe administrata

Gjatë vitit 2021 janë realizuar gjithsej nga akreditimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim 2.613.000 lekë të ardhura, të cilat janë derdhur të gjitha në buxhetin e shtetit.

Shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2021, krahasuar me planin e celur në fillim të vitit, paraqiten si më poshtë :

Artikulli	Emërtimi	Plan	Fakt	% realizimit
600	Paga	14.911.000	14.757.000	99%
601	Sigurime shoqerore	3.041.000	2.434.000	80%
602	Shpenzime operative	3.500.000	3.000.000	86%
606	Transferta	50.000	46.000	92%

Viti 2021 nga pikëpamja financiare ka funksionuar si cdo vit tjetër. Nuk kemi asnjë detyrim financiar në fatura të palikujduara si ndaj subjekteve privatë, ashtu edhe ndaj insitucioneve shtetërore.

Numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2021 ka qenë 22 punonjës, kurse numri në fakt i punonjësve ka qenë 19. Kemi patur 3 vende vakante :

- 1 – Përgjegjës Sektori i Monitorimit dhe Cilësisë (mbartur nga vitet e tjera)
- 1 – Përgjegjës Sektori i Informimit dhe Marrëdhënieve me Publikun (mbartur nga vitet e tjera)
- 1 – Specialist Sektori i Ricertifikimit (mbartur nga vitet e tjera)